



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10162 Prot

Gjirokastër më 05.11:2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 31.10.2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 31.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 31.10.2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te auditori pranë Universitetit "Eqrem Çabej". Mbledhja fillon në orën 12:05

Marrin pjesë në mbledhje 22 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Feruni, E. Shehaj, Koçollari, Drasa, Rova, Guçe, Caca, Aliko

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 02.10.2024.
2. P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.10.2024".
3. P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.10.2024".
4. P/Vendim "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë 2025".
5. P/Vendim "Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit".
6. P/Vendim "Për miratimin e kërkesave për dhënien me qira me afat 10 vjeçar të disa parcelave kullosore, fond publik në pronësi të bashkisë Gjirokastër".
7. Raporti i monitorimit 8-mujor të buxhetit 2024 në Bashkinë Gjirokastër.
8. Të ndryshme.

Znj. Isaraj lexon dhe paraqet para këshillit 2 pikat shtesë të propozuara nga ekzekutivi:

1. P/Vendim "Për një ndryshim në VKB nr. 113, datë 14.12.2023 "Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024".

P/Vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencës civile".

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro procesverbalin e mbledhjes së datës 02.10.2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.10. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31. 10. 2024”, të cilat miratohen me 22vota pro.

Kalohet te pika 4 e rendit të ditës e cila ka kaluar në Komisionin e Çeshtjeve sociale, Barazisë Gjinore dhe Shëndetësisë.

Z. Arianit Muho: Ne si komision e kemi kaluar për t’u trajtuar më tej në mbledhjen e këshillit.

Hidhen në votë dhe miratohen me 22 vota pro dy pikat4, 5 të rendit të ditës.

4.P/Vendim “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë 2025”

5.P/Vendim “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit”.

Kalohet te pika 6 P/Vendim “Për miratimin e kërkesave për dhënien me qira me afat 10 vjeçar të disa parcelave kullimore, fond publik në pronësi të bashkisë Gjirokastër”.

Z. Brahim: çfarë përfiton bashkia nga këto dy kontrata.A janë shpallur në ankand?

Z.Onjea: Këto sipërfaqe prej 25 vjetësh me kontrata 6 dhe 12 mujore kanë qenë të kontraktuara nga këto familje.

Z. Golemi:Të gjithë blektorët që I kanë zbatuar kushtet e kontratave për vite me radhë janë të favorizuar në bërjen e kontratave. Është hapur thirrja nga AZHBR për grante për stalla për fermerët, por kusht është kenë kontrata minimumi5-vjeçare. Ju kam bërë thirrje kryetarëve të fshatrave edhe në dëgjuesat publike që kemi qenë që të informojnë fermerët për përfitimet.

Sa herë që të kemi kërkesa do të vijnë me emra të përveçëm.

Z. Brahim: Unë nuk jam kundër, por dua të di përfitimet.

Z. Qeli: Brenda bazës ligjore, si e ka rregulli, ne miratojmë në parim dhënien e tyre.

Z. Novi: Është më mirë që të merren nga fermerët, do merren edhe mbrojtjen nga zjarri. Vetëm mos e lënë me nënkontraktim?

Z. Golemi: Nuk e lejon kontrata nënkontraktimin.

Z.Hilaj:Kemi miratuar edhe 2 kontrata më parë në këshill, më tej vazhdon te noteri, ne si këshill u hapim rrugën. Jam dakort .

Znj..Isaraj: hidhet në votë dhe miratohet pika e parë shtesë.

Miratohet me 22 vota pro.

“Për një ndryshim në VKB nr. 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

Hidhet në votë pika e dytë shtesë dhe miratohet me 22 vota pro. P/Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencës civile”.

Z. Brahim: Çfarë kenë menduar për punonjësit e shërbimeve komunitare në lidhje me pagat?

Z. Golemi: I kemi mbështetur , por kuadri ligjor në këtë shtesën që u miratua në mbledhjen e kaluar nuk I përfshin, pasi janë përfshirë gjatë vitit 2023 në dy rritje .

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj në orën 12:35

Sekretar I Këshillit
Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT
Merita ISARAJ

